



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

KËSHILLI KONSULTATIV
QEVERISJE QENDRORE - VETËQEVERISJE VENDORE

Nr 144 prot

Tiranë, më 10.3 2026

VENDIM

Nr. 3 datë 10.3. 2026

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTAKTEVE OBJEKT KONSULTIMI NË MBLEDHJEN E
KËSHILLIT KONSULTATIV, QEVERISJE QENDRORE – VETËQEVERISJE
VENDORE TË DATËS 3/3/2026

Këshilli Konsultativ bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, si dhe në VKM nr.244, datë 17.4.2024 “Për mënyrën e organizimit e të funksionimit të Këshillit Konsultativ të Qeverisjes Qendrore me Vetëqeverisjen Vendore”, pas shqyrtimit të projektakteve të mëposhtme të mbledhjes së datës 3.3.2026 vendosi:

1. Për projektligjin “Për policinë bashkiake”, propozuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:
- Të përcaktohet mënyra e vjeljes së gjobave nga bashkitë e vogla për arsye të mos disponimit të instrumenteve shtrënguese ekzekutive, si rezultat i mospasjes akses në databazën shtetërore për bllokim mjjetesh, pezullim shërbimesh apo masa të tjera administrative si dhe kufizime në kapacitetet njerëzore dhe financiare;

- Të përcaktohet në ligj që Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit të Policisë Bashkiake të ketë kompetencë ligjore për të koordinuar me Policinë e Shtetit për ekzekutimin e gjobave të Policisë Bashkiake, si dhe Policia e Shtetit të ofrojë asistencë për ekzekutim administrativ, bllokim mjetesh apo shërbimesh kur parashikohet nga ligji apo referim për ekzekutim të detyrueshëm sipas procedurave ligjore;
- Të përcaktohet nëse kompensimi për shërbimin e ekzekutimit, të jetë simbolik ose i mbuluar nga buxheti i shtetit dhe jo nga të ardhurat e bashkive;
- Neni 8, pika 1, vendosja e këtij detyrimi sjell vështirësi për bashkitë e vogla, të cilat kanë aktualisht një numër të vogël punonjësish të Policisë Bashkiake dhe në këto bashki mund të mos jetë e nevojshme krijimi i një drejtorie dhe organizimi mund të mbetet në nivel sektori për të shmangur dhe kostot përkatëse;
- Neni 8, pika 2 të formulohet si vijon; Unifikimi i standardeve operacionale të Policisë Bashkiake do të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit e cila është autoriteti përgjegjës për administrimin e portalit unik të rekrutimit dhe trajnimit;
- Neni 8, pika 3, të bashkohet me pikën 1, si dhe neni 8, pika 4 duhet të hiqet sepse është përsëritje e tekstit;
- Neni 9 pika 2, gërma (a) dhe (b) të bashkohen duke u formuluar si vijon: “përcakton dhe orienton zbatimin e zbatimin e politikave të veprimtarisë së Policisë Bashkiake, me qëllim rritjen dhe garantimin e sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, mbarëvajtjen e punëve publike, miradministrimin e hapësirave publike dhe mbrojtjen e mjedisit në territoret e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë”;
- Neni 10, pika 3, të saktësohet, nëse prefekti do ketë autoritet rregullator për të caktuar se cilat kompetenca ka Policia e Shtetit apo Policia Bashkiake, ndërkohë i vetmi mekanizëm është kontrolli i ligjshmërisë që prefekti ushtron mbi aktet normative të njësive vendore;
- Neni 10, pika 4, të qartësohen përgjegjësitë që mund ti delegohen prefektit, ndërkohë që përgjegjësitë e Ministrisë lidhur me Policinë Bashkiake parashikuar në nenin 9 janë rregullatore dhe në nivel kombëtar;
- Neni 11, në linjë me nenin 9 dhe nenin 10, të shtohet pika 1 me përmbajtje; “Kryetari i bashkisë është autoriteti përgjegjës për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Policisë Bashkiake në përputhje me dispozitat e këtij ligji”;
- Neni 11, gërma (a) dhe (b) mund të bashkohen dhe të formulohen si vijon; “planifikon buxhetin vjetor dhe siguron ambiente dhe pajisje për funksionimin e Drejtorisë së Policisë Bashkiake”;
- Neni 11, gërma (c), të formulohet si vijon; “Cakton prioritetet dhe orienton veprimtarinë e Policisë Bashkiake pas konsultimeve me komunitetin, organizatat jofitimprurëse, Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit”;
- Neni 11, gërma (ç), të qartësohet shkrehja “projektet e veprave që miratohen nga ana e Policisë bashkiake”
- Neni 11, gërma (d), termat “trajnim, kualifikim periodik dhe rritje e aftësive profesionale” mund të zëvendësohen me termin “kualifikim profesional”;
- Neni 11, gërma (dh), të qartësohet nëse është e nevojshme të përfshihet bashkëpunimi ndërkombëtar në ligj, ndërkohë që Kryetari i Bashkisë kërkon dhe vendos bashkëpunime për shumë fusha të veprimtarisë së tij dhe nuk ka nevojë të shtohet si përgjegjësi specifike në ligj;
- Neni 12, gërma (a), ndjekja dhe analizimi realizohen në zbatim të pikave d, dh, e dhe ë;
- Neni 12, gërma (c), të qartësohet nëse planifikimi dhe rekrutimi i personelit do jetë i standardizuar për të gjitha bashkitë njësoj apo do të varet organizimi dhe numri i punonjësve nga kritere si popullsia, gjeografia dhe zhvillimi ekonomik;

- Neni 13, pika 1, sugjerohet të hiqen fjalët “në të gjitha bashkitë e vendit”;
- Neni 14, pika 1, gërma (a), sugjerohet që shprehja “akteve rregulatore dhe akteve në zbatim të ligjit” të zëvendësohen me termat “vendimeve, urdhërave dhe urdhërësive” në përputhje me Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”;
- Neni 14, gërmat (ç) dhe (d), të hiqen për të mos pasur përsëritje sepse janë të rregulluara nga pika 4 e nenit 13;
- Neni 14, gërma (e), të qartësohet roli i policisë bashkiake në rast se vërehen shkelje;
- Neni 14, gërma (i), termi “mbikqyr” të zëvendësohet me termin “siguron”, kjo referuar Ligjit nr. 55/2025 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa”, ku Policia Bashkiake jo vetëm mbikqyr, por dhe siguron respektimin e normave etike përmes inspektimit dhe vendosjes së gjobave;
- Neni 14, gërmat (l), (ll) dhe (n), të konkretizohet roli i Policisë Bashkiake dhe çfarë nënkuptohet me termin “bashkëpunon”, që mund të jetë shoqërimi gjatë inspektimeve, shkëmbimi i informacionit, etj..;
- Neni 14, gërma (nj), sugjerohet që Policia Bashkiake të jetë përgjegjëse për zbatimin e planeve bashkiake për nivelin e lejuar të zhurmave të prodhuara nga muzika të cilat janë aktualisht përgjegjësi e Policisë së Shtetit;
- Neni 14, i cili parashikon një listë të gjatë detyrash e përgjegjësish të Policisë Bashkiake të cilat duhet të ndahen në dy kategori, detyra operacionale që janë zakonisht proaktive, si dhe gjuha e përdorur në projektligj, e veçanërisht në nenin 14 duhet të saktësohet për të sjellë qartësi dhe lehtësi në zbatim për bashkitë dhe institucionet e tjera të përfshira;
- Neni 15, pika 2, pika 4 duhet të bashkohen duke shtuar në pikën 2 të riformuluar si vijon; “punonjësi i Policisë Bashkiake merr masa administrative për shkeljet e konstatuara sipas procedurave të legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative”;
- Neni 15, pika 3, të hiqet shprehja “punonjësi i strukturës konstatuese”;
- Neni 15, pika 4, duhet të bashkohet me pikën 2;
- Neni 34, pika 2, të formulohet si vijon; “Trajnimet e punonjësve të Policisë Bashkiake duhet të kryhen kryesisht nga Akademia e Pushtetit Vendor, duke pasur parasysh se Policia Bashkiake nuk kryen detyra operacionale të njëjta me Policinë e Shtetit, si dhe trajnimet nga institucioni arsimor i Policisë së Shtetit duhet të jenë në përputhje me statusin e Policisë Bashkiake;
- Neni 53, pika 2, të formulohet si vijon; Policia Bashkiake ka stemën dhe shenjën dalluese unike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat përdoren në uniformën e Policisë Bashkiake, “së bashku me stemën dhe flamurin e bashkisë”;
- Neni 53, pika 5, të hiqet dhe të bashkohet me pikën 2;
- Neni 54, pika 1, të rishikohet për të përcaktuar mjete të komunikimit dhe mjete vetëmbrojtjeje për punonjësit e Policisë Bashkiake;
- Neni 55, pika 1, të qartësohet nëse punonjësi i Policisë Bashkiake mund të kontrollojë identitetin referuar dhe nenit 15, pika 3;
- Neni 55, pika 2, sugjerohet që të jetë pjesë e trajnimeve apo Rregullores së Policisë Bashkiake dhe nuk duhet të përfshihet në këtë nen;
- Neni 3, të shtohet përkufizimi i “Statusit të veçantë” dhe të përcaktohet qartë statusi juridik;
- Neni 5, të rregullohet në përputhje me përkufizimin e statusit që do të përcaktohet në nenin 3;
- Neni 12, gërma (c) paraqitet e paqartë mënyra e propozimit për planifikimin dhe rekrutimin e personelit dhe krijon konfuzion në interpretim. Kërkohet riformulim dhe

- qartësim i procedurës dhe autoritetit përgjegjës për rekrutimin, dhe pse në vijim kjo kompetencë i takon Kryetarit të Bashkisë;
- Neni 22, pika 3, të rishikohet për përmirësim të formulimit dhe saktësim të përmbajtjes. Të citohet: “Sektori i Burimeve Njerëzore pranë bashkisë”, dhe jo “pranë Drejtorisë Vendore”;
 - Neni 26, pika 4, të rishikohet, pasi institucioni është institucion varësie dhe nuk disponon Njësi të Burimeve Njerëzore (BNJ) të brendshme. Funkzioni i BNJ-së realizohet nga burimet njerëzore pranë bashkisë përkatëse;
 - Neni 28, “Emërimi i punonjësit të Policisë Bashkiake”. Në pikën 2 të shtohet edhe: “Kandidatët që janë pjesë aktuale e Policisë Bashkiake (të cilët synojnë promovimin)”;
 - Neni 31, të rregullohet gërma (f), ose të hiqet, pasi për sa kohë ekziston Drejtori i Përgjithshëm për standardizimin e Policisë Bashkiake, nuk mund të anashkalohet hierarkia duke njoftuar drejtpërdrejt Ministrin e Brendshëm apo Ministrin përgjegjës për pushtetin vendor dhe një veprim i tillë përbën tejkalim të kompetencave hierarkike, duke qenë se ky nen citon kompetencat e Drejtorit Vendor të Policisë Bashkiake;
 - Neni 33, “Vlerësimi i performancës”, pika 2, të ndryshohet si më poshtë: Rastet e vlerësimit të rezultateve individuale në punë për punonjësit janë: a) vlerësimi periodik vjetor, b) në periudhë prove; c) me kërkesën e vetë punonjësit;
 - Neni 47, gërma (d), të rishikohet duke ndryshuar si më poshtë: d) punonjësin më të vjetër në rol drejtues në strukturën e Drejtorisë Vendore të Policisë Bashkiake;
 - Kreu V, “Procedimi disiplinor në Policinë Bashkiake”. “Masat parandaluese për shkeljet disiplinore”. Masa parandaluese ka për qëllim parandalimin e përsëritjes ose përsëritjes të mangësive të konstatuara gjatë veprimtarisë së përditshme të punonjësit të policisë, pa iniciuar procedurë disiplinore. Masat parandaluese janë: a) “këshillim”, b) “tërheqje vëmendjeje”;
 - Neni 47, “Procedura disiplinore”, të rregullohet pika 4/c, duke përcaktuar “Përgjegjësi i burimeve njerëzore pranë bashkisë”, pasi Drejtorja Vendore e Policisë Bashkiake nuk ka njësi të BNJ-së;
 - Pika 5 bie ndesh me pikën 4, ku përcaktohet se “Komisioni i disiplinës ngrihet me urdhër të Drejtorit të Policisë Bashkiake”. Kjo dispozitë duhet të rishikohet, pasi komisioni nuk mund të ngrihet me urdhër të Drejtorit, duke qenë se pjesë e komisionit është nëpunësi civil më i lartë në bashki. Komisioni duhet të ngrihet me urdhër të Kryetarit të Bashkisë dhe jo të Drejtorit Vendor të Policisë Bashkiake;
 - Neni 51, “Masat disiplinore”, të shtohet; “Pezullim nga detyra për një periudhë nga 3 muaj deri në 1 vit, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave”, për të shmangur vakumin ligjor në rastet kur punonjësi është arrestuar për një vepër penale, duke mbajtur në konsideratë parimin e prezumimit të pafajësisë dhe deri në shprehjen e autoriteteve gjyqësore, ai të qëndrojë i pezulluar;
 - Të shtohet neni “E drejta për përfitim kredie të lehtësuara për strehim”, si vijon; Punonjësi i Policisë Bashkiake përfiton kredi të lehtësuara për strehim, sipas rregullave dhe kushteve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi që rregullon kreditë e lehtësuara për blerjen e banesës për të punësuarit në administratën publike;
 - Të shtohet neni “Trajtimi i familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës” si vijon; Kur punonjësi i Policisë Bashkiake humb jetën për shkak të detyrës, pjesëtarët e familjes përfitojnë, a) ndihmë të menjëhershme financiare deri në 3 paga mujore, sipas pagës referuese të muajit të fundit, b) pension familjar suplementar në

masën 100% të pagës mujore të muajit të fundit kalendarik të shërbimit, pavarësisht nga periodha e sigurimit. Përfitimi jepet në masën 100% të pagës dhe rillogaritët sa herë që ndryshon paga mbi të cilën është llogaritur, c) organizimin e ceremonisë mortore nga drejtuesi i strukturës përkatëse, me shpenzime të përballuara nga buxheti i bashkisë, si dhe rregullat dhe procedurat e trajtimit të familjarëve të punonjësve që humbin jetën për shkak të detyrës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

- Të saktësohen kompetencat në projektligj sepse krijon një strukturë komande me dy autoritete paralele mbi Policinë Bashkiake, duke gjeneruar konflikte të mundshme kompetencash dhe pengesa operationale si:
- Neni 30, rregullat dhe procedurat e përzgjedhjes së Drejtorit të Drejtorisë Vendore përcaktohen me udhëzim të ministrit, bazuar në propozimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, ku kryetari i bashkisë emëron Drejtorin Vendor, por sipas rregullave të vendosura nga ministria, kufizon pavarësinë vendore në zgjedhjen e strukturave të veta;
- Neni 34 parashikon se kostot e trajnimeve përballohen nga buxheti i Drejtorisë Vendore, pra nga buxheti i bashkisë, ndërkohë që programet dhe vendimet për trajnimet kontrollohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit pranë Ministrisë dhe ky parashikim krijon një pabarazi të qartë ku bashkia mban barrën financiare, por nuk ka autoritet vendimmarrës;
- Neni 33 parashikon se Kryetari i Bashkisë shqyrton ankesat e punonjësve lidhur me vlerësimin e performancës “në koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit”, i cili nënkupton se vendimmarrja e Kryetarit të Bashkisë nuk është e pavarur, por e kushtëzuar nga miratimi i një organi qendror;
- Neni 31 parashikon detyrimin e Drejtorit Vendor “të informojë ministrin përgjegjës” drejtpërdrejt për problematikat e rendit dhe sigurisë vendore. Ky parashikim anashkalon Kryetarin e Bashkisë si autoritet mbikëqyrës vendor dhe krijon një kanal komunikimi paralel me qeverinë qendrore, duke dobësuar llogaridhënien e brendshme vendore;
- Neni 30, të ndryshohet në mënyrë që rregullat e rekrutimit të Drejtorit Vendor të miratohen nga kryetari i bashkisë, duke u mbështetur vetëm në standardet teknike minimale të përcaktuara nga Drejtoria e Përgjithshme si referencë, jo si detyrim;
- Neni 34, të sqarohet duke parashikuar se bashkia ka të drejtë të propozojë dhe miratojë programet e trajnimeve sipas nevojave specifike të territorit të saj, duke ruajtur standardet kombëtare vetëm si kuadër orientues;
- Neni 33, të ndryshohet duke hequr formulimin “në koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme”, në mënyrë që shqyrtimi i ankimeve nga Kryetari i Bashkisë të jetë i pavarur dhe përfundimtar në nivel vendor;
- Neni 31, të ndryshohet duke parashikuar se Drejtori Vendor raporton dhe informon Ministrin vetëm nëpërmjet Kryetarit të Bashkisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara shprehimisht me ligj.

2. *Për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për trajtimin ekonomik dhe financiar të familjarëve të punonjësve të policisë së shtetit që humbin jetën për shkak të detyrës, dhe të punonjësve që plagosen dhe dëmtohen gjatë ose për shkak të detyrës”,* propozuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Të përcaktohet në projektvendim se si të përkthehet në një proces real pa u bërë një barrë për bashkinë, pra një skemë të qartë ligjore se si t'u jepen familjarëve të policëve të rënë/dëmtuar dhe nëse këta punonjës policie do paguajnë qira, sa do jetë ajo, apo si do të trajtohen nga Këshilli Bashkiak;
- Të qartësohet në projektvendim termi “banesë falas” për punonjës policie, gjë që nënkupton kalim pronësie, ndërkohe Ligji “Për strehimin social” ia ndalon bashkisë dhurimin e pronës publike të saj pa patur një bazë ligjore;
- Kreu VII gërma (a), pika 1, të hiqet togfjalëshi “Ose Njësitë e Vetqeverisjes Vendore ose në administrimin e tyre” si dhe në pikën 6, kreu VII, togfjalëshi “Njësitë të Vetqeverisjes Vendore”, me qëllim shmangien e një përplasje të dispozitave të këtij projektakti me dispozitat e kuadrit ligjor në fuqi “Për strehimin Social”, i ndryshuar.

3. Për projektvendimin “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 173 datë 24.3.2023, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, planit të veprimit për zbatimin e saj si dhe planit të zbatimit të garancisë rinore 2023-2024”, i ndryshuar, propozuar nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet përkatëse të ardhura në postën elektronike për t’u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Të përshihet pushteti vendor në sistemin kombëtar të integruar për analizimin e tendencave të tregut të punës dhe aftësive, duke siguruar shkëmbimin e detyrueshëm dhe të standardizuar të të dhënave elektronike midis institucioneve përkatëse;
- Të përfshihet pushteti vendor pjesë integrale e funksionimit të kësaj zyre lëvizëse, e cila do të mundësonte një qasje më të integruar të shërbimeve, duke përfituar nga përvoja dhe strukturat ekzistuese vendore në fushën e orientimit në karrierë dhe aktivizimit të të rinjve në tregun e punës;
- Të publikohet informacioni i fushatës edhe në portalet institucionale të bashkisë Tiranë, konkretisht në: www.tirana.al www.karriera.tirana.al; në kuadër të bashkëpunimit institucional dhe për të rritur shtrirjen e komunikimit me qytetarët;
- Të përfshihen bashkitë, veçanërisht ato me struktura të konsoliduara në fushën e ofrimit të shërbimeve të këshillimit për karrierë për të rinjtë dhe komunitetin, të konsiderohen si aktorë të rëndësishëm në hartimin dhe zbatimin e këtij kuadri, duke kontribuar me praktikën dhe eksperiencën e tyre në nivel vendor;
- Të përcaktohet saktë roli i bashkive për zbatimin e PZGR-së, koordinimi dhe standartizimi i proceseve do të sjellë një zbatim sa më efektiv të këtij plani;
- Të hiqet përmbajtja “Pilotimi i shërbimeve mbështetëse pas shkollorë”, i përcaktuar në pikën 5 të “Plani i zbatimit të garancive rinore”, pasi përmbajtja e kësaj pike nuk përputhet me politikat vendore të bashkisë Tiranë. Pilotimi i projektit pas shkollor (After school) është iniciativë e Ministrisë së Arsimit. Vlera e përcaktuar në plan si kosto dhe burim financimi i bashkisë Tiranë, nuk është referuar nga bashkia Tiranë dhe për këtë pikë bashkia Tiranë nuk është angazhuar me propozim për një vlerë financiare.

4. Për projektvendimin “Për miratimin e formatit tip të marrëveshjes që lidhet nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Investitorit për të drejtën e përdorimit të brigjeve të deteve, liqeneve, lumenjve si destinacione plazhi”, propozuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, bashkitë pjesëmarrëse në Këshillin Konsultativ, mbështetur në mendimet e tyre, miratuan rekomandimet/komentet

përkatëse të ardhura në postën elektronike për t'u reflektuar nga institucioni propozues si më poshtë:

- Të parashikohet qartësisht e drejta e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për t'u konsultuar paraprakisht, për të monitoruar zbatimin e marrëveshjes dhe për të kërkuar ndërhyrje në rast shkeljesh, në përputhje me praktikën e vendeve të BE-së;
- Të parashikohen mekanizma të strukturuar monitorimi dhe raportimi periodik për të garantuar respektimin e kushteve kontraktore dhe mbrojtjen e interesit publik;
- Të përfshihen dispozita që lejojnë ndërhyrje administrative të shpejtë, përfshirë pezullimin ose zgjidhjen e marrëveshjes në rast shkeljesh të rënda, mosrespektim të standardeve të sigurisë apo ndotjes së mjedisit;
- Të publikohet marrëveshja dhe elementët kryesorë të saj, në funksion të rritjes së transparencës dhe besimit publik, në përputhje me standardet ndërkombëtare për administrimin e pronës publike;
- Të theksohen detyrimet për mbrojtjen e mjedisit dhe përdorimin e qëndrueshëm të brigjeve, në përputhje me praktikën e Bashkimit Europian për menaxhimin e zonave bregdetare;
- Të forcohet roli i bashkive jo vetëm si përfituese financiare, por edhe si aktorë institucionalë në procesin e zbatimit dhe monitorimit të marrëveshjes, përfshirë konsultimin paraprak, të drejtën për monitorim dhe adresim të problematikave që lidhen me administrimin e brigjeve dhe mbrojtjen e interesit publik dhe territorial;
- Të përfshihet pushteti vendor më gjerësisht në këtë proces;
- Të qartësohet referenca e këshillit bashkiak, ndërkohë tarifën e nxjerr Ministria e Financave dhe pagesat i bën po sipas tarifës që nxjerr Ministria e Financave;
- Të saktësohet/shtohet në projektvendim roli mbikqyrës i pushtetit vendor në zbatimin e kriterëve dhe standardeve nga Investitori Strategjik;
- Të qartësohet në projektvendim se çfarë ndodh nëse subjekti nuk paguan brenda afatit prej 30 ditëve.
- Të saktësohet neni 8, “zgjidhja e marrëveshjeve”, gërma (c) dhe neni 9, “njoftimi për zgjidhjen e marrëveshjes”, pika 2, pasi bien ndesh me njëri-tjetrin, ku në nenin 9, pika 2 citohet që “në rast se plotësimi i afatit të përcaktuar mësipër konstaton se përdoruesi nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për përmbushjen e detyrimit financiar, dhënësi ka të drejtë të zgjidhë menjëherë këtë marrëveshje me përdoruesin për shkak të mospërmbushjes”;
- Të saktësohet se ku shkojnë penalitetet për mos zbatimin e kriterëve për stacionet e plazhit pasi ato duhet ti kalojnë pushtetit vendor si përfitues.
- Të ndryshohet termi “marrëveshje” në termin “kontratë”, nisur nga parashikimet në këtë projektvendim kemi të bëjmë me një kontratë dhe jo me një marrëveshje, ku përcaktohen detyrime ligjore dhe të drejta për palët, penalitete, afate dhe mundësia për t'ju drejtuar gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, pra të gjitha elementët përbërës të një kontrate;
- Të përfshihet bashkia në marrëveshje si palë e interesuar në marrëveshjen që lidhet ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe Investitorit;
- Neni 7, pika 2 e Vkm-së nr. 649, datë 16.10.2024, “Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit””, të ndryshuar, e përjashton këtë vendim si bazë ligjore për rregullimin e dhënies së hapësirave për stacione plazhi për subjektet investitore strategjike;

- Të zëvendësohet termi “brigje” me termin “hapësirë plazhi në det, liqen dhe lum” sepse mund të shkaktojë paqartësi;
- Të njoftohet zyrtarisht bashkia nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit për procesverbalin e dorëzimit të hapësirës për përdorimin e brigjeve të deteve, liqeneve, lumenjve si stacione plazhi, që jepet në përdorim;
- Të marrë masa për të mundësuar aksesin e publikut në plazh, në rast të bllokimit të rrugëve ekzistuese nga subjekti;
- Neni 8, gërma (c), bie në kundërshtim me pikën 2 të nenit 9, pasi zgjidhja e marrëveshjes për mospagim të detyrimeve nuk është e nevojshme të shqyrtohet nga gjykata. Për të njëjtën shkëlqje (mospagesa e tarifës), neni 8 kërkon vendim gjykate, ndërsa neni 9 lejon zgjidhje direkte nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) brenda 30 ditëve, gjë që përben dy rrugë të papajtueshme dhe risk për bashkinë, si dhe paqartësi proceduriale;
- Të ndërmerret nisma nga strukturat përgjegjëse për çështjet e turizmit, zhvillimit ekonomik dhe financave pranë bashkisë Tiranë, për kryerjen e propozimeve përkatëse në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Vkm nr. 649/2024, e ndryshuar, dhe referimin e këtij detyrimi në zbatimin e mundshëm në të ardhmen të projektvendimit “Për miratimin e formatit tip të marrëveshjes që lidhet ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe investitorit për të drejtën e përdorimit të brigjeve”;
- Neni 4, të përcaktohet e drejta e bashkisë për të qënë pale kontraktuese në marrëveshje sepse risku qëndron se bashkia nuk mund të ngre padi si palë kontraktore;
- Neni 8/3 bie ndesh me nenin 8/4, ku neni 8/3 kërkon kthim të brigjeve “në gjendje origjinale”, ndërsa neni 8/4 lejon heqjen e “përmirësimeve të ndashme”. Kufiri ndërmjet strukturave është i papërcaktuar, si dhe duhet të saktësohen mekanizmat e vlerësimit paraprak për kthimin në gjendje origjinale të brigjeve të dëmtuara;
- Neni 8 bie ndesh me nenin 9 pasi ka paqartësi proceduriale dhe procesi gjyqësor zgjat 2-4 vjet gjatë të cilave tarifa nuk arkëtohet e cila sjell humbje direkte e të ardhurave vjetore për bashkinë.

Z. Ervin Demo
Ministër Shteti për Pushtetin Vendor

Z. Aldrin Dalipi
Kryetar/Bashkëkryetar

Shoqata e Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë